



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SANJA A. TELHALLARI
ADRESA Njesia Administrative Kashar,
Unaza e Re, Rr."Teodor Keko"
TEL: +355672022444

KONTRATË DHURIMI PASURI E

LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 10017

Nr. koleksioni: 5536

Tirane më 23/05/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2023052120543595848



KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI TË SHOQËRISË "A.M.U" SHPK

Sot, para meje Notere **SANJA A. TELHALLARI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Administrative Kashar, Unaza e Re, Rr."Teodor Keko", u paraqit personalisht:

DHURUES:

Roland Veseli, atësia Mehmet, amësia Lumturi, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë, me adresë Him Kolli; Nd. 00; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 03/03/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033620451 dhe nr. personal G90303198V, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")

PRANUES I DHURIMIT:

Mirea Bega, atësia Roland, amësia Mimoza, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Mihal Duri; Nd. 63; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 21/07/1997, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037738847 dhe nr. personal J75721072K, .

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

MEQENËSE:

Shoqëria "**A.M.U**" SHPK (më poshtë referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri me përgjegjesi te kufizuar e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT K14229210F, me seli ne Rr. "Fushe Kruje FUSHE KRUJE Autostrada Fushe Kruje - Laç, km 1.5.", Tiranë, me një kapital prej 110.000.000,00 Lek), i ndarë në Kuota te pergjithshme me vlere nominale prej 2,00 sikurse rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar lëshuar nga QKR për të dhënat e Shoqërisë;

- Dhuruesi është ortak i Shoqërisë, me kapital Para:56.100.000,00 Lek dhe kuota 1,00 që përfaqësojnë 51 % pjese të kapitalit themeltar të Shoqërisë (në vijim "**Aksione**");
- Nëpërmjet kësaj Kontrate Dhuruesi dëshiron t'i transferoje Pranuesit te Dhurimit gjithsej Para: 56.100.000,00 Aksione, qe përfaqësojnë 1 kuot të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
- Pranuesi i Dhurimit dëshiron te fitoje pronësinë mbi 51% Aksione te Dhuruesit, ne vlere lekesh Para: 56.100.000,00 si me lart, që përfaqësojnë 1 kuote të Shoqërisë;
- Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë, dhe pas miratimit të këtij transferimi sipas Vendimit të Asamblesë se Aksionareve te Shoqërisë date 22/05/2023, vendim i njohur dhe pranuar plotësisht nga Palët e qe i bashkëlidhet kësaj Kontrate, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;



ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

- 1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Dhuruesi i dhuron dhe i kalon ne pronësi Pranuesit të Dhurimit dhe Pranuesi i Dhurimit pranon të fitojë dhe marrë në pronësi nga Dhuruesi gjithsej 1 KUOTE qe përfaqësojnë 51% te Aksioneve të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Neni 2 Deklarimet dhe garancitë

- 2.2. Dhuruesi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron aksionet që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'i transferuar këto aksione dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.
- 2.3. Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Pranuesi i Dhurimit ka tagra të plota për të pranuar aksionet nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi i Dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi i Dhurimit.

Neni 3 Transferimi i pronësisë mbi aksionet

- 3.1. Transferimi i pronësisë mbi aksionet e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kryhet nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, meqenëse Asambleja e Përgjithshme e Aksionareve të Shoqërisë ka dhe miratuar me Vendimin e saj datë 22/05/2023 këtë transferim dhe ndryshimet e Statutit të Shoqërisë..
- 3.2. Pas transferimit të pronësisë mbi aksionet sipas kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kapitalit themeltar të Shoqërisë do të jetë si vijon:
- Znj.Mimoza Veseli mbetet zotërues i 49 % aksioneve, 1,00 numri i kuotave qe përfaqësojnë 53 900 000 leke te kapitalit aksionar te Shoqërisë;
 - Z.Mirea Bega bëhet zotërues e 51% aksioneve, 1,00 numri i kuotave qe përfaqësojnë 56 100 000 leke te kapitalit aksionar te Shoqërisë;
- 3.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi aksionet e zotëruara në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.
- 3.4. Transferimi i pjesës së kapitalit të dhuruar nga Përfituesi drejt personave të tretë do të jetë subjekt i të drejtës se parablerjes në favor të Dhuruesit i cili mund ta shfrytësojë këtë të drejtë sipas të drejtave të përcaktuara në dispozitat e Statutit të Shoqërisë dhe si më poshtë.
- 3.5. **Në rast se Përfituesi kërkon të shesë dhe/ose transferojë një pjese ose të gjithë kuotën e tij, ai duhet ti ofrojë fillimisht Dhuruesit kuotën që propozohet të transferohet ("Kuotën e Ofruar"), subjekt i kërkesave dhe kushteve të mëposhtme dhe Statutit të Shoqërisë:**
- 3.6. Përfituesi duhet t'i dërgojë fillimisht Dhuruesit një njoftim me shkrim duke detajuar vlerën dhe përqindjen në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë të Kuotës së Ofruar, dhe kushte të tjera materiale të transfertës ("Oferta"), duke ftuar fillimisht Dhuruesin të blejë Kuotat e Ofruara duke shfrytëzuar të drejtën e parablerjes. Kuota e ofruar ndaj



A2023052120543595848

Dhuruesit do ti jepet këtij të fundit me të njëjtat kushte sipas së cilave Përfituesi synon ta transferojë drejt palëve të tretë.

- 3.7. **Dhuruesi ka të drejtë që të blej/pranoj vec e vec në dhurim Kuoten e Ofruar sipas kushteve të Ofertës duke dërguar një njoftim me shkrim tek Përfituesi.**
- 3.8. **Në rast se Dhuruesi nuk zgjedh të blej Kuotën e Ofruar dhe/ose ka refuzuar të blej këtë Kuotë të Ofruar apo një pjesë të saj, sipas mënyres së përcaktuar, Përfituesi do të ketë të drejtë të transferojë Kuotën e Ofruar tek një palë e tretë në përputhje me kushtet e Ofertës fillestare.**

Neni 4 Te ndryshme

4.1 Garanci te tjera.

Palët bien dakord që të ndërmarrin ato veprime të tjera të cilat nuk parashikohen shprehimisht në këtë Kontratë, sic mund të jetë e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e dhurimit të pjesës së kapitalit të dhuruar sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë. Me ndryshimin apo hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, rregulli apo rregulloreje që do të ndikojë në aftësinë e Dhuruesit për të dhuruar pjesën e kapitalit që zoteron apo të Përfituesit për të pranuar pjesën e kapitalit të dhuruar sipas kushteve të kësaj Kontrate, Palet bien dakord që të ndërmarrin këto veprime te tjera sic mund të jetë e nevojshme apo e dëshirueshme dhe pranojnë në mirëbesim të kryejnë keto procedura sic mund të jetë e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e dhurimit të pjesëve të kapitalit, në përputhje me të gjitha ligjet, rregullat ose rregulloret që bëhen të zbatueshme; me kusht, gjithsesi, që asnjëra Palë të mos i kërkojë që të ndërmarrë ndonjë prej këtyre veprimeve ape të respektojë këto procedura që do t'i shkaktonin një barrë të rëndë apo kosto dhe shpenzime shtesë.

4.2 Forca Madhore.

Asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve të saj përkatëse sipas kësaj Kontrate në rastin e Forcës Madhore. Për qëllimet e kësaj Kontrate, Forca Madhore do të nënkuptojë një ngjarje e cila nuk mund të parashikohet apo mënjanohet dhe që shkon përtej kontrollit të palëve duke e bërë të pamundur përmbushjen e cfarëdo detyrimi që rrjedh nga kjo Kontratë.

4.3 Marrëveshja.

Kjo Kontratë përbën të gjithë Marrëveshjen dhe zëvendëson te gjitha marrëveshjet dhe rregullimet e mëparshme, verbale dhe të shkruara, ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

4.4 Transferimi.

Asnjëra palë nuk do të ketë të drejtë të japë apo transferojë te gjitha apo cilëndo prej të drejtave të saj, përfitimeve apo detyrimeve sipas kësaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

4.5 Efektet detyruese.

Kjo Kontratë do të ketë fuqi detyruese për Palët.

4.6 Vecueshmëria.



Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ajo do të modifikohet në minimumin e nevojshëm për ta kthyer të vlefshme, të ligjshme dhe të zbatueshme, ose, nëse një modifikim i tillë nuk është i mundur, kjo dispozitë do të mënjanohet nga kjo Kontratë dhe dispozitat e tjera të kësaj Kontrate do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi dhe të vlefshme.

4.7 Ligji i zbatueshëm.

Kjo Kontrate dhe të gjitha transaksionet e parashikuara në të do të rregullohen, interpretohen dhe do të jenë të zbatueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Cdo konflikt, ndryshim, mosmarrëveshje apo pretendim i cfarëdo loji, sido që të ketë lindur, nga apo në lidhje me këtë Kontratë, përfshirë cdo pyetje që i përket mospërmbushjes, ekzistencës, vlefshmërisë apo zgjidhjes së kësaj Kontrate të cilat nuk zgjidhen në mënyrë miqësore mes Palëve, do t'i drejtohet dhe zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Baza Ligjore

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma “ç” (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma “ç” (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar
- Neni 62, gërma “ll”, neni 63, pika 1, gërma “ç”, si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e dhurimit, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DHURUES:

Roland Veseli

Roland Veseli

PRANUES I DHURIMIT:

Mirea Bega

Mirea Bega

M Bega



NOTERE
SANJA A. TELHALLARI

[Signature]